

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GE-AN”SH.P.K**

Shoqeria “GE-AN”SH.P.K themelohet ne baze te iniciatives dhe kapitalit themeltar te ortakeve themelues .

Ortaket themelues te shoqerise:

1. Anilda Amheti me ID J05402101J
2. Gert UKU me ID J20930097I

Ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise Nr.9901 date 14.04.2008 ‘‘Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare’’, i ndryshuar dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 ‘‘Per Qendren Kombetare Te Regjistrimit’’, te ndryshuar.

**NENI 1
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Emri i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar eshte “GE-AN”SH.P.K
Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e Aktit te Themelimit e te ketij Statuti.

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

2.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtronte në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Import dhe eksport, instalim, mirmbajtje, tregti me pakice dhe shumice' te paisjeve kompjuterike, kancelarike, telefonike, elektronike, mekanike, te telekomunikacionit, elektrike, ndricim, hidraulike, impjanteve e paisjeve termosantare, paisje kondicionimi e ngrohje - ftohjeje e aksesore te tjere te lidhura me to. Import, eskport i te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, brenda dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise apo te treteve, ku perfshihen dhe materialet termosantare si dhe cdo material tjetër që perdoret per qellime ndertimi. Prodhimi, perpunimi, montimi i impianteve termosantare, instalimi e mirembajtja e tyre. Import, eksport, tregtim me shumice e pakice i paisjeve industriale, elektrike, elektroshtepiake, artikujve te mobilerise etj. Import, eksport e tregtim i mjeteve motorike, autovetura, kamione, mjete bujqesore, e pjese kembimi te tyre. Ushtrim aktiviteteve reklamuese e publikimeve me qellim reklamimi. Pjesmarrje dhe organizimi i ekspozitave, panairove dhe aktiviteteve te ngjashme brenda dhe jashte vendit. Konsulenc per hartimin e projekteve elektrike te ndricimit dhe ndertimit gjithashtu studim, projektim dhe zbatim per projektet elektrike, ndricim, ndertim. Transport kombetar e nderkombetar. Blerje, shitje, te pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Qirramarrje, qiradhenie dhe leasingut, pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, mallrave dhe produkteve per realizimin e qellimit kryesor te shoqerise. Te fitoje, direkt apo indirekt interesa ne shoqeri te tjera te cilat kane nje objekt te ngjashem me ate te Shoqerise , ne Shqiperi ose jashte saj. Sherbime informatike dhe telefonike. Shperndarje interneti. Krijim dhe mirembajtje faqesh interneti. Krijim dhe shperndarje programe kompjuterike. Konsulence teknike dhe riparim pajisje kompjuterike dhe elektronike. Sherbim Printimi. Tregtim, import dhe eksport, instalim, mirembajtje dhe tregtim i sistemeve te fonise, sistemeve te alarmit, sistemeve te alarmit kundra zjarrit, sistemeve te kamerave te survejimit dhe vezhgimit CCTV, sistemeve te akses kontrollit, sistemeve te biletarive elektronike, sisteme aparaturash mjekesore, sisteme UPS, stabilizator, gjeneratore, radio nderlidhje, sistemeve me fiber optike etj. Ndertim linjash elektrike mbitokesore, ajrore, nentokesore, kablllore per energjiine elektrike, linja fuqie dhe telekomunikacioni, nenstacione elektrike te larta e te mesme, Projektim dhe zbatim te Hec-ve, Projektim, zbatim dhe supervizim i rrjeteve LAN, WAN, MAN, sistemeve te ashensoreve te ndryshem. Tregtim te pajisjeve laboratorike per profile mjekesore, bujqesore, blegtorale,

universitare, mjedisore kerkimore etj. Import eksport reagente, kimikate kite materiale konsumi spitalore e laboratorike. Shitje dhe blerje te materialeve, pajisjeve te fermave, stallave impianteve prodhuese dhe ndertimeve te kabineteve te ndryshem laboratorik per te gjitha profilet. Import dhe eksport me shumice dhe pakice te te gjitha produkteve te pastrimit. Konsulenc per Licencat profesionale ne kolaudim , projektim dhe zbatim gjithashtu konsulenc per Licencat e subjekteve ne zbatim, projektim dhe zbatim.

2.2 Për më tepër shoqëria mund të veproje si kontraktor i përgjithshëm për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontrakti palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha punimeve.

2.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave.

2.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizoi drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë cdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptarë apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose të huaj.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Shoqëria ka seline e saj në adresën me Rr. Selman Riza, Nd.2, H.1, Nj. Administrative Nr. 3,1005, Tirane.

Aktiviteti i shoqërisë do të zhvillohet në Tirane dhe do të shtrihet në të gjithë territorin shtetror të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një afat të papercaktuar, me mundësinë e zgjatjes apo të shkurtimit të afatit, të ndryshojë veprimtarinë, emertimin, seline, objektin e veprimtarisë sipas vendimit të ortakëve të shoqërisë .

NENI 5

DETYRIMET E ORTAKËVE

Ortakët e Shoqërisë duhet të kryejnë depozitimin e kapitalit themeltar për llogaritë të Shoqërisë në një bankë të caktuar prej tyre.

NENI 6

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Ortakët mund të kalojnë pjesë nga kapitali themeltar subjekteve dhe personave të tjerë në përputhje me rregullat e parashikuara në Neni 73 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare".

Në rast shitje kuotash Ortakët aktual kanë të drejtën e parablerjes. Pasi është përmbushur kjo pike, e drejta e parablerjes së Ortakëve aktual, vetëm atëherë Ortakët mund të ofrojnë kuotat e tyre Shoqërive dhe personave të tjerë jashtë shoqërisë.

NENI 7

PARAQITJA KONTABILE

Operacionet e Shoqërisë kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit të parashikuara në legjisllacionin shiptar dhe paraqitjen me saktësi në bilancin vjetor.

Në mbyllje të cdo viti Ortakët ose personi i ngarkuar prej tyre, bëjnë inventarizimin dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat e legjisllacionit në fuqi për kontabilitetin dhe hartojnë raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e Shoqërisë gjatë vitit financiar.

NENI 8

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Leke, dhe është i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale 50 leke secila.

Te zoteruara:

- 50 % Ortaku Anilda Ahmeti , 1 kuote me vlere nominale 50 Leke
- 50 % Ortaku Gert Uku , 1 kuote me vlere nominale 50 Leke

NENI 9 OPERACIONET FINANCIARE

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

NENI 10 BLERJET E SHOQERIVE

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e Shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

NENI 11 FONDI REZERVE

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e saj. Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga Ortaket ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te Shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne Leke, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe perlllogaritjet ekonomike te Shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

NENI 12 PLANET FINANCIARE

Aktiviteti i Shoqerise mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin financiar te saj. Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat e shprehura ne Leke. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do te paraqiten ne Leke. Rezultatet financiare te aktivitetit dhe te punes se kryer nga Shoqeria, paraqiten ne bilancin vjetor. Kursi i kembimit te monedhes shqiptare ne monedhat e huaja dhe e kunderta do te jene ato te vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

NENI 13 ORGANET E SHOQERISE

Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per Shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a)percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise
- b)ndryshimet e Statutit
- c)emërimin e shkarkimin e Administratorëve
- ç)emërimin e shkarkimin i Likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
- d)percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike
- dh)mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- e)miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- ë)zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- f)pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g)përfaqësimin e Shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorëve
- gj)riorganizimin dhe prishjen e Shoqerisë
- h)miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë
- i)çështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo Statuti.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij Neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- c) investime
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 14 ORGANET E SHOQERISE

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga Ligji 9901 date 14.04.2008, nga Ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët apo Ortakët e përcaktuar sipas Neni 84 të këtij Ligji.

Asambleja e Përgjithshme thirret nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një Ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij Neni, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e Administratorëve.

NENI 15 MËNYRA E THIRRJES

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet në Statut, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë Ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij Neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë Ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 16 KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në Statut, mund t'i drejtojnë Administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat Asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta Ortakë kanë të drejtë ta thërrasin Asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të Neni 83 të këtij Ligji.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij Neni dhe thirrja i është njoftuar Ortakëve, Administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e Neni 14 të Statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të Ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të Ortakut të përfaqësuar.

NENI 17 PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim nga një Ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e Shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i Ortakëve në Asamblesë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 18 KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas Neni 87 të Ligji 9901 date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse Ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të Neni 88 të këtij Ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij Neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 19 MARRJA E VENDIMEVE

Me përjashtim të rasteve kur Statuti parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me 3/4 e votave të Ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të Neni 86 të Ligji 9901 date 14.04.2008, për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Ligj ose në Statut, për çështjet e tjera të renditura në Neni 81 të Ligjit Per Shoqërite Tregtare, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të Ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi Ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë Ligj ose në Statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakut përkatës.

NENI 20 PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLE SË

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse Shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në këtë faqe.

NENI 21 ADMINISTRATORI

Shoqeria administrohet nga nje ose disa persona fizike. Administratori i Shoqerise emerohet me vendim te Ortakeve te Shoqerise. Afati i qendrimt ne detyre i Administratorit eshte per nje periudhe 5 (pese) vjecare.

Administrator i Shoqerie caktohet Znj. **Anilda Ahmeti**

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe u njeh Ligji shprehimisht Asamblese ose te treteve. Administratori ka pergjegjesi ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te Ligjeve, Statutit apo shkeljeve te kryera gjate administratimit. Administratori ne rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

NENI 22

RASTET E PUNES

Raportet e punes ndermjet Shoqerise, filialeve dhe agjensive te saj si dhe te punonjesve ne te, rregullohen ne baze te Kontrates se Punes, konform Kodit te Punes.

Per sa nuk parashikohet ne keto Kontrata, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 23

Shoqeria merr persiper, te shlyej rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

NENI 24

PERFUNDIMI I AKTIVITETIT

Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakeve falimenton, behet i paafte ose vdes.

Shoqeria prishet:

- 1.Me kalimin e afatit per kohezgjatjen e saj.
- 2.Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.
- 3.Me vendim gjykate.
- 4.Me hapje te procedurave te falimentit.

NENI 25

LIKUJDIMI

Likujdimi i Shoqerise behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

NENI 26

KUSHTET E TJERA

Te gjitha vendimet e mara nga Asambleja evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e Shoqerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete Statut do ti referohen plotesimeve qe mund te bejne Ortaket si dhe Ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Per regjistrimin e Shoqerise dhe depozitimin e akteve prane QKR, autorizohet Administratori i saj.

Nënshkruar, sot më datë 26/09/2022

ORTAKET THEMELUES

Anilda AHMETI

Gert UKU